

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, koleji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Mr.sc.Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses H. A., Komuna e Prishtinës, të cilën e ka përfaqësuar Z. I., avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës K. e S. “D.”, me seli në Prishtinë, për zhdëmtimin material dhe jomaterial, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.2341/2013 datë 23.5.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 24.10.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës K. e S.“Dardania”, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.2341/2013 datë 23.5.2016, në pjesën që i referohet kompensimit të dëmit jomaterial paditëses për dhimbje fizike, frikë dhe shëmtim.

II. Me pranimin e pjesshëm të revizionit të të paditurës, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.2341/2013 datë 23.5.2016 dhe mbetet në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.242/2011 datë 7.3.2013, përkitazi me kompensimin e dëmit jo material paditëses H. A., në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shuma prej 4500 €.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.2341/2013 datë 23.5.2016, pjesërisht aprovohet ankesa e të autorizuarit të paditurës dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.242/2011 datë 7.3.2013, ndryshohet në paragrafin II të dispozitivit ku përmendet shuma e përgjithshme e dëmit të gjykuar dhe në vend të 14.523,00 € të gjykuar, gjykohej 10.523,00 €, kurse në vend të kamatës së gjykuar, gjykohej kamata sipas përqindjes të cilën e zbatojnë bankat komerciale për mjetet e deponuara, pa destinim të caktuar mbi 1 vit, e cila kamatë duhet të llogaritet nga dita e kryerjes së ekspertizës më 09.01.2013 deri në pagesën përfundimtare, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm. Me pjesën II të dispozitivit, në paragrafin II.1, aktgjykimi i ankimuar ndryshohet në emër të përjetimit të dhimbjeve fizike, në vend të 4.500 € të gjykuar, gjykohej 2.500 €. Me pjesën III. të dispozitivit, në paragrafin II.2 aktgjykimi i ankimuar ndryshohet edhe në emër të frikës së përjetuar në vend të 3.000 € të gjykuar, gjykohej 2.000 €. Me pjesën IV. të dispozitivit, në paragrafin II.4 aktgjykimi i ankimuar ndryshohet dhe në vend të 4.500 € të gjykuar, në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësore, gjykohej 3.000 €. Me pjesën V. të dispozitivit, në paragrafin III, aktgjykimi i ankimuar ndryshohet, në pjesën përtej shumave të gjykuara, kërkesëpadia e paditëses refuzohet si e pabazuar. Me pjesën VI. të dispozitivit, në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar vërtetohet, kurse ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, revizion me kohë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohet përkitazi me kompensimin e dëmit jo material dhe paditëses për të gjitha format e dëmit t'i pranohen shumat e gjykuara me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në shumë prej 14.523 €, me kamatë 8%, nga data 07.03.2013, e deri në pagesën definitive.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është pjesërisht i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datën 15.12.2009, në rrugën magjistrale Podujevë-Prishtinë afër shtëpisë së zjarrfikësve ka ndodhur aksidenti i trafikut, në të cilin aksident paditësen, në cilësinë e këmbësore, e cila ka ecur rrugës, e ka goditur automjeti-furgon "VW 253" me targa të regjistrimit ..., të cilin e ka drejtuar E. A., i siguruar tek e paditura. E paditura nuk e ka kontestuar se fajin për aksidentin lëndor e ka pasur ngasësi i automjetit, i siguruari i saj dhe në gjykatën e shkallës së parë, ky fakt nuk është dëshmuar.

Nga ana e ekspertëve mjekësorë, dr.Xh. S., ortoped-traumatolog dhe dr.V. S., psikiatër, është vërtetuar se paditësja H. A., ka pësuar ndrydhje të krahavorit dhe të trupit të shoqëruar me thyerje të hapur të gradës së dytë të kërcit të majtë. Ndrydhje në regjionin e kofshës së djathtë. Këto lëndime nga ekspertët karakterizohen si lëndime të rënda trupore. Si pasojë e lëndimeve të marra paditësja ka përjetuar dhimbje fizike, frikë, shëmtim të shkallës së mesme për shkak të vrazës së thellë me gjatësi 17 cm, e çrregullimit në vendin ku ka qenë thyerja e hapur me gjerësi prej 0.5 cm, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 15%, për shkak të kufizimit të lëvizjeve të shuplakës së këmbës së majtë në shkallë të lehtë. Po ashtu, ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj në kohëzgjatje prej 70 ditëve si dhe rehabilitim fizioterapik-klimatik në kohëzgjatje prej 30 ditësh për vitin e parë pas aksidentit dhe 20 ditë tjera për vitin e dytë pas aksidentit.

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka vlerësuar se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit dhe pjesërisht e ka miratuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 154, 158 të LMD-së.Lartësinë e shumave e ka gjykuar në bazë të dispozitës së nenit

323 të LPK-së duke pasur parasysh intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, intensitetin e frikës, shkallën e shëmtimit, zvogëlimin e aktivitetit jetësor si dhe shpenzimet e shërimit, ka miratuar kërkesëpadinë e paditëses si në pjesën I. dhe II. të dispozitivit.

Me pjesën III. të dispozitivit, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar për kompensimin e dëmit mbi shumat e gjykuara: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1.000 €, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 500 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 1.500 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 230 €, dhe në emër të ushqimit të përforcuar 330 €, në emër të shpenzimeve të rehabilitimit klimatik 150 €.

Me pjesën IV. të dispozitivit, e paditura është detyruar që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 818,00 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka miratuar pjesërisht si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe me pjesën I. të dispozitivit ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për dhimbjet fizike, frikën dhe zvogëlimit të aktivitetit jetësor, duke gjykuar shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate. Po ashtu, ka ndryshuar edhe normën e kamatës duke gjykuar kamatën sipas përqindjes të cilën e zbatojnë bankat komerciale për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar mbi 1 vit, e cila kamatë duhet të llogaritet nga dita e kryerjes së ekspertizës më 09.01.2013, deri në pagesën përfundimtare, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Pjesët tjera të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ka vërtetuar dhe ankesën e të paditurës e ka refuzuar si të pabazuar.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se, gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale

kur ka gjetur se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të cilën paditësja e ka pësuar në rastin e aksidentit në komunikacion me fajin e të siguruarit të paditurës.

Për sa i përket shumave të gjykuara, me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, paditëses përkitazi me dhimbje fizike të përjetuara, frikën, shëmtimin, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate mbi gjendjen e tillë faktike të vërtetuar, drejt është zbatuar dispozita e nenit 200 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të LPK-së, përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit jomaterial, të precizuar si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ngase, shumat e caktuara në emër të dëmit jomaterial janë caktuar në bazë të ekspertizës së ekspertëve mjekësorë në të cilën janë përshkruar lëndimet të cilat i janë shkaktuar paditëses në aksidentin e komunikacionit - intensiteti i dhimbjeve fizike, intensitetit të frikës.

Vlerësimi i shpërblimit për dëmin jomaterial përfaqëson zbatimin e të drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jomaterial, gjykata sipas nenit 200 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për çështjen që të mos favorizojë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jomaterial dhe qëllimin shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditëses, shkallën e intensitetit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës, shkalla e shëmtimit, sipas gjendjes së vërtetuar nga ana e ekspertëve siç u tha më sipër, e duke pas parasysh praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shumat e caktuara të shpërblimit të dëmit jomaterial paditëses, në pjesën I të dispozitivit, të gjykatës së shkallës së dytë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate të revizionit, janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas kësaj dispozite dhe në harmoni me praktikën gjyqësore për gjykimin e dëmit jomaterial të kësaj natyre, për të cilën arsye gjykatat e shkallës së dytë, drejt kanë zbatuar të drejtën materiale. Prandaj, janë të pabazuara parashtrimet në revizion se shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë janë jo reale dhe në disproporcion me natyrën dhe pasojat eventuale të lëndimeve.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë përkitazi me shumën e gjykuar në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor në shumë prej 3.000 €. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë në këtë pjesë është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale (neni 224.1 të LPK-së) për arsye se kjo formë e dëmit nuk është caktuar në mënyrë reale në bazë të shkallës së zvogëlimit të aktivitetit jetësor dhe praktikën gjyqësore për gjykimin e kësaj forme të dëmit. Andaj, sipas mendimit të kësaj Gjykate, shuma e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në lartësi prej 4.500 €, është ekuivalente me shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor dhe praktikës së kësaj Gjykate për gjykimin e formës së tillë të dëmit. Prandaj, me të drejtë theksohet në revizion se në këtë pjesë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me zbatimin e të drejtës materiale për çka u vendos si në pjesën II të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Thëniet në revizion se aktgjykimet e të dy gjykatave, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme, për faktin se e paditura në revizion nuk saktëson se ku konsistojnë këto shkelje, ndërsa Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion (neni 215 të LPK-së).

Thëniet në revizion se në rastin konkret të dy gjykatat gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e caktimit të normës së kamatës për faktin se është dashur të gjykohet kamata ligjore prej 8% (nenin 382 të LMD-së), kjo Gjykatë i cilësoi si të papranueshme dhe si të tilla i refuzoi për faktin se padia në këtë kontest është iniciuar me datën 3.2.2010 në kohën kur ka qenë në fuqi ligji i vjetër i LMD-së dhe në bazë të dispozitës së nenit 1057 të ligjit të ri të LMD-së, (që ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012), ligji i ri i LMD-së, nuk gjejnë zbatim në rastin konkret.

Thëniet tjera në revizion kjo Gjykatë i vlerësoi si pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështjeje juridike për faktin se, vërejtjet e tilla në këtë fazë të procedurës nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes.

Nga sa u tha më sipër, me zbatimin e dispozitës së nenit 222 dhe 224.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Më 24.10.2016, Rev.nr.232/2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani